



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS



FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



**Strategjia e Kërkimit Shkencor
në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja**



Miratuar me Vendim Dekanati

nr. 135 datë 20.12.2022



Strategjia e Kërkimit Shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja

2022-2024

Hyrje

Misioni i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, i mbështetur në një trashëgimi të mirë të kërkimit shkencor dhe në përfaqimin e praktikave më të mira kombëtare e ndërkombëtare, synon të konsolidojë identitetin e institucionit jo vetëm si qendër e prodhimit të dijes dhe të profesionistëve të ardhshëm, por edhe shndërrimin në një institucion elitare kërkimor, produkti shkencor i të cilit kërkohet e vlerësohet nga tregu, por edhe të përmirësojë në vazhdimësi mësimdhënien dhe ekspertizën e stafit dhe përvojën studentore.

Zgjerimi i marrëveshjeve me universitete shqiptare dhe të huaja në drejtim të kërkimit shkencor do të rrisë ndjeshëm numrin e pjesëmarrjeve në projekte shkencore në kuadër të thirrjeve për projekte me fonde të BE-së por edhe më gjerë.

PRIORITETE ZHVILLIMORE TË STRATEGJISË SË KËRKIMIT SHKENCOR

- FGJH do të vijojë bashkëpunimet me institucionet publike dhe sektorin privat, për të vlerësuar interesin e tyre për shërbimet që ofrohen lidhur me aplikimin e elementeve të gjetjeve kërkimore të dala prej tij.
- FGJH do t'i japë përparësi mbështetjes financiare të kërkimit shkencor duke nxitur pjesëmarrjen më të gjerë në aktivitete kërkimore, në projekte të caktuara apo pjesëmarrjen në konferenca kombëtare e ndërkombëtare të pedagogëve dhe studentëve por edhe duke përmirësuar shërbimin e bibliotekës nëpërmjet digjitalizimit të saj.
- FGJH do të ketë një plan të strukturuar të kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor i strukturuar në tematika të caktuara, në objektiva dhe rezultate të pritshme do të orientohet nga planet e kërkimit të grupeve kërkimore brenda departamenteve si edhe nga plani individual i angazhimit në kërkim shkencor i çdo anëtari të personelit akademik, sipas ligjit të arsimit të lartë në fuqi dhe statutit të UT-së.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



OBJEKTIVAT KRYESORE NË ZBATIM TË STRATEGJISË SË KËRKIMIT SHKENCOR TË FGJH-SË

Objektivi 1 : Zhvillimi i qasjes ndërdisiplinore në kërkim

Ky objektiv është i rëndësishëm për disa arsye:

- a) Kërkimi është më efektiv kur studiuesit me ekspertizë nga fusha të ndryshme bashkëpunojnë në një projekt kërkimi të përbashkët.
- b) Sa më shumë studiues të bashkëpunojnë, aq më të mëdha janë shanset për sukses dhe zgjidhjen e problemeve.
- c) Në rastin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ku fushat e studimit ndërthuren me njëra tjetrën si gjuhësia, komunikimi, kultura, letërsia bashkëpunimi mes grupeve mësimore –kërkimore është i rëndësishëm për të ndërmarrë studime gjithëpërfshirëse.
- d) Bashkëpunimi me ekipe të tjera hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare e bën kërkimin një proces më të lehtë, duke shkëmbyer informacione mbi situata të ngjashme me të tjerët dhe duke përdorur teknikat dhe përvojat e tyre më të suksesshme. Ky objektiv synon t'i japë përparësi veprimtarisë kërkimore në nivelin e njësisë bazë dhe të Fakultetit, por duke mos përjashtuar veprimtarinë individuale.

Veprimet

- 1.1. Krijimi i profileve të kërkimit të institucionit dhe riorganizimi i programit të doktoratës.
- 1.2. Përgatitja e paketës së projekteve kërkimore.
- 1.4. Hartimi i rregullores së brendshme të FGJH-së, pranimit dhe mbikqyrjes për kërkuesit doktorantë, bazuar në udhëzimet e UT dhe Ligjit të Arsimit të Lartë për rekrutimin e kërkuesve shkencorë
- 1.5. Krijimi i një baze të dhënash për kërkimin.
- 1.6. Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore.
- 1.7. Zhvillimi i marrëdhënieve të reja kërkimore me bizneset dhe institucionet e tjera akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 1.8. Integrim më i mirë i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Zonën Evropiane të Kërkimit.
- 1.9. Përdorimi i fondit të kërkimit për të mbështetur nismat e reja kërkimore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



1.10. Hartimi i projekteve për orientimin e studimeve të ciklit të tretë si dhe projekteve të tjera që do t'i shërbejnë rritjes dhe gjallërimit të punës shkencore brenda institucionit, bashkëpunimve me institucione të tjera kërkimore për realizimin e produkteve finale me karakter aplikativ.

Rezultatet e pritshme

- 1.2. Paketa e aplikimit në programin e doktoratës dhe e projektit kërkimor.
- 1.3. Krijimi i zyrës së projekteve.
- 1.4. Baza e të dhënave kërkimore.
- 1.5. Sigurimi i një mbështetjeje financiare për pjesëmarrjen në aktivitetet kërkimore ndërkombëtare.
- 1.6. Përfshirja e kandidatëve të rinj të programit të doktoratës në projektet e njëjësive bazë.
- 1.7. Rregullorja e brendshme e doktoratës

Objektivi 2: Kryerja e kërkimeve që të kenë ndikim në shoqëri

Duke vlerësuar se kërkimi shkencor ka ndikime të konsiderueshme në shoqëri, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka përcaktuar si një objektivi kryerjen e kërkimeve për çështje që e interesojnë shoqërinë në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja, gjuhësisë dhe komunikimit ndërkulturor, teknikave dhe metodologjive të përkthimit dhe interpretimit.

Veprimet

- 2.1. Bashkëpunimi me institucione kombëtare për të identifikuar problematikat që kërkojnë zgjidhje.
- 2.2. Identifikimi i projekteve kërkimore që kanë ndikim në zhvillimin e shoqërisë.
- 2.3. Përcaktimi i projekteve kërkimore që do të ndërmarrë FGjH në kuadër të riorganizimit të programeve të studimit të doktoratës.
- 2.4. Ngritja e ekipeve mësimore - kërkimore.
- 2.5. Aftësimi më i madh në shkrimin e projekteve dhe aplikime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare
- 2.6. Aplikimi për fonde për mbështetjen e kërkimeve.



Rezultatet e pritshme

- 2.1. Paketa e projekteve.
- 2.2. Raportet e kërkimeve.
- 2.3. Publikimi i rezultateve të kërkimeve.
- 2.4. Paraqitja e rezultateve të kërkimeve audiencave të interesuarve.
- 2.5. Pjesëmarrje në thirrje për trajnime apo ditët informuese mbi projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 2.6. Zhvillimi i trajnimeve brenda institucionit për shkrimin e projekteve.
- 2.7. Krijimi i burimeve financiare të qëndrueshme për kërkimin shkencor përmes hartimit dhe pjesëmarrjes në projekte me përfitim të drejtpërdrejtë për institucionin si dhe bashkëpunimin me fushën e biznesit apo me sektorë të ndryshëm të kulturës dhe të ekonomisë për të pasur përfitime të ndërsjella si dhe gjenerimin e fondeve përmes ofrimit të shërbimeve me të tretët.
- 2.8. Krijimi i një baze të dhënash (data base) në faqen e FGJH me thirrjet për projekte

Objektivi 3: Ndërthurja e kërkimit me mësimdhënien

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja synon:

- a) që pedagogët të jenë kërkues aktivë, të transferojnë në mënyrë të natyrshme rezultatet e kërkimit në mësim;
- b) që mësimi të aftësojë studentët të ushtrohen për detyra kërkimore;
- c) që mësimi të ilustruhet me arritjet shkencore të fushës.

Veprimet

- 3.1. Integrimi në mësimdhënien e rezultateve të kërkimeve aktuale sipas lëndëve mësimore.
- 3.2. Mësimdhënien e orientuar drejt kërkimit, e cila do të realizohet nëpërmjet të kuptuarit dhe zbatimit të metodologjive, aftësive dhe teknikave të kërkimit në disiplina mësimore.
- 3.3. Mësimdhënien e bazuar në mentorimin kërkimor, e cila do të realizohet nëpërmjet mentorimit të pedagogëve për shkrimin e kumtesave për konferencën e studentëve, për punimet e diplomës; për vlerësimin e punimeve shkencore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



3.4. Mësimdhënia e bazuar në kërkim, e cila do të realizohet nëpërmjet detyrave kërkimore të shkallës së vogël në lëndë të veçanta; si ese, studim rasti, analiza klinike.

Rezultatet e pritshme

- 3.1. Përfshirja e kërkimeve të personelit akademik të FGJH në listën e literaturës së lëndëve mësimore.
- 3.2. Mbledhja e të dhënave shkencore nëpërmjet veprimtarive mësimore dhe kërkimore.
- 3.3. Mentorimi nga pedagogët i punimeve të diplomës.

Objektivi 4: Zhvillimi i aftësive kërkimore të studentëve

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja synon që specialistët e ardhshëm të kenë kapacitetin të integrojnë kërkimin në praktikën e tyre profesionale:

- për shkak të natyrës praktike të profesioneve për të cilat ata përgatiten;
- për shkak se ata duhet të zbulojnë dhe analizojnë problemet që mund të ndeshin në punën e tyre të ardhshme;
- për shkak se ata duhet të jenë të aftë të studiojnë dhe të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale në vijimësi.

Veprimet

- 4.1. Trajnimi i studentëve për kërkimin.
- 4.2. Mentorimi i studentëve për kërkimin.
- 4.3. Përfshirja e studentëve në grupet e kërkimit.
- 4.4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi i studentëve në kulturën e sipërmarrjes dhe mbështetja e tyre në procesin krijues, zhvillimin e projekteve, qofshin ato profesionale, shoqërore, etj.)

Rezultatet e pritshme

- 4.1. Paketa e punimeve të kërkimore.
- 4.2. Përgatitja e manualit për kërkimin shkencor për studentët.
- 4.3. Organizimi i konferencës së përvitshme të studentëve.
- 4.4. Botimi i revistës me punimet e studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



4.5. Pajisja me aftësi kërkimore e studentëve për të kryer kërkime të llojeve të ndryshme.

4.6. Nxitja e përdorimit sa më efektiv të literaturës së përditësuar që sigurohet nga fondi për blerje librash sipas kërkesave të paraqitura nga njësitë bazë.

4.7. Digjitalizimi i bibliotekës së FGJH

4.8. Abonimi në revista shkencore prestigjioze.

Objektivi 5: Rritja e shikueshmërisë të kërkimit shkencor të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

Aktualisht Fakulteti i Gjuhëve të Huaja boton revistën e tij shkencore si edhe numëron një numër të madh botimesh të anëtarëve të tij në revista të huaja prestigjioze në gjuhë të huaja. FGJH synon të rrisë shikueshmërinë e produktit të tij kërkimor duke rritur prestigjin e revistës së tij shkencore dhe shpërndarjen e rezultateve të kërkimit shkencor.

Veprimet

5.1. Botimi i revistës shkencore në vijim dhe sigurimi i statusit të saj si revistë shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

5.2. Ngritja e një sistemi për të hetuar dhe parandaluar plagjiaturën në çdo kërkim shkencor të prezantuar.

5.3. Hartimi dhe zbatimi i një plani Komunikimi për Kërkimin Shkencor brenda FGJH-së që identifikon, njeh dhe informon sukseset e kërkimit shkencor, duke i bërë të aksesueshëm edhe për publikun.

5.4 Organizimi i të paktën një konference ndërkombëtare në vit.

5.5. Zgjerimi i lidhjeve me partnerët strategjikë të kërkimit nëpërmjet rrjeteve.

5.6. Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve kërkimore-shkencore sipas kodit të cilësisë.

Rezultatet e pritshme

5.1. Marrja e numrit ISSN internatioanal portal; regjistrimi në bazën e të dhënave EBSCO

5.2. Sigurimi i sistemit parandalues të plagjiaturës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



5.3. Krijimi i Ditës së Kërkuesve shkencorë në FGJH me qëllim informimin mbi projektet e reja apo ato të përfunduara.

5.4. Krijimi i çmimit të Kërkimit shkencor më të mirë

5.5 Një bazë të dhënash për projektet kërkimore dhe partnerët kërkimore.

5.6. Organizimi i konferencës ndërkombëtare çdo vit.

5.7. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare.

5.8. Rritja e anëtarësisë institucionale dhe individuale në shoqata profesionale ndërkombëtare

Objektivi 6: Zgjerimi i partneriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin dhe kërkimin

Veprimet

6.1. Identifikimi dhe më pas zhvillimi i partneriteteve që lidhen me pikat e forta dhe ambiciet kërkimore të FGJH-së.

6.2. Do të synojmë institucionet e arsimit të lartë me performancë të lartë dhe partnerët kërkimore që lidhen dhe mbështesin pikat e forta të zhvillimit dhe kërkimit tonë dhe mund të rrisin vlerën dhe ndikimin e kërkimeve tona.

Rezultatet e pritshme

6.1. Rritja e numrit të marrëveshjeve të partneritetit për zhvillim dhe kërkim.

6.2. Rritja e numrit të projekteve të përbashkëta të zhvillimit dhe kërkimit.

Objektivi 7: Rritja e lëvizshmërisë së studentëve dhe shkëmbimit të stafit për zhvillimin e kërkimit

Veprimet

7.1. Promovimi i mundësive për shkëmbimin e studentëve të ofruara nga Programet e Bashkimit Evropian, si Erasmus +, Programet e Përbashkëta Master, Partneritetet Erasmus Mundus, programet dypalëshe të vendeve ose programe të tjera ndërkombëtare.

7.2. Ofrimi i mundësive për stafin akademik për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare që ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit ndërkombëtar dhe integrimin e çështjeve globale në kontekstin kërkimor.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



7.3. Shtimi i numrit të personelit akademik ndërkombëtar, i pedagogëve vizitorë/ kërkuesve vizitorë.

7.4. Krijimi i një baze të dhënash që përmban informacion mbi stafin ekzistues ndërkombëtar, lidhjet institucionale dhe burimet e financimit dhe mundësive strategjike.

Rezultatet e pritshme

7.1. Rritja e numrit të shkëmbimit të studentëve.

7.2. Rritja e numrit të shkëmbimit të stafit.

7.3. Një bazë të dhënash mbi shkëmbimet ndërkombëtare.

7.4. Zhvillimi i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe funksioni këshillues ndërkombëtar

Objektivi 8: Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor dhe monitorimi i tij

Institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton përmbushjen e objektivave të tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime duhet të çojnë në përmirësim të vazhdueshëm të programeve. Vlerësimi i programeve të studimit dhe kërkimit shkencor realizohet sipas mënyrës së bazuar në standarde. Në funksion të sigurimit të cilësisë, në bazë të raporteve të monitorimit dhe të vlerësimit kryhet përmirësimi i kërkuar.

Veprimet :

8.1. Përdorimi i instrumentave dhe raportimit të vlerësimit të veprimtarisë dhe aktiviteteve kërkimore – shkencore në njësinë bazë.

8.2. Vlerësimi i tematikave sipas fushave të studimit kërkimor në njësitë bazë.

8.3. Vlerësimi vjetor i progresit dhe veprimtarive kërkimore – shkencore të doktorantit.

Rezultatet:

8.1. Raport vjetor dhe të dhëna statistikore të veprimtarive kërkimore – shkencore bazuar në pritshmëritë dhe rekomandimet e analizës vjetore të cilësisë në njësinë bazë.

8.2. Analiza e pyetësorëve për tematikat prioritare të zhvilluara brenda fushave të paracaktuara.

8.3. Analiza e pyetësorit për shqyrtimin e progresit të kërkimeve të studentit.



ZBATIMI, RAPORTIMI, MONITORIMI, VLERËSIMI I STRATEGJISË SË KËRKIMIT SHKENCOR TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA

Kjo strategji do të ndjekë të gjitha standardet ndërkombëtare të raportimit, komunikimit, monitorimit, vlerësimit dhe ndjekjes së zbatimit. Këto standarde garantojnë përmbushjen e misionit dhe objektivave të parashikuara në kuadër të vizionit të strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Zbatimi dhe vlerësimi

Zbatimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor të FGJH-së do të shtrihet në një hark kohor prej 3 (tri) vitesh, në periudhën 2021-2024. Rol udhëheqës për zbatimin e saj do të ketë Dekania e Fakultetit. Zbatimi do të kryhet në nivel njësie bazë duke harmonizuar të gjithë komponentët e Planit të veprimit, përgjatë shtrirjes në 3 (tri) vitet e parashikuara.

Disa aspekte që lidhen me vlerësimin janë:

- Cilat janë prioritetet e Strategjisë dhe nëse objektivat dhe rezultatet e pritshme /aktivitetet e planit të veprimit janë të harmonizuara me prioritetet e Strategjisë së kërkimit shkencor?
- A janë arritur objektivat në krahasim me synimet e vendosura? Cilat janë arsyet e mos-realizimit të objektivave?
- A do të çojnë aktivitetet dhe rezultatet e programuara në arritjen e rezultateve dhe të objektivit?
- A mundet që objektivat dhe rezultatet e Planit të Veprimit të arrihen më mirë duke zbatuar një kombinim të ndryshëm të aktiviteteve?





Vlerësimi përfundimtar i ecurisë së Strategjisë së Kërkimit Shkencor do të jetë i brendshëm dhe do të kryhet nga një komision kolegjal i përbërë nga : Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Zv. Dekani për anën Kërkimore, Përgjegjësit e Departamenteve, Koordinatorët e grupeve mësimore-kërkimore sipas njësive bazë.

Vlerësimi do të kryhet 1 një herë në vit, në fund të vitit akademik përkatës.

Tabela 1: Kriteret e vlerësimit: Ex-ante i ndërmjetëm Ex-post

Kriteri 1. Rëndësia A do ta zgjidhë problemin ndërhyrja e synuar? Cilave nevoja u përgjigjet ajo? A ka ndryshuar nevoja origjinale? A kërkon ndryshimi një rregullim të përputhshëm me ndërhyrjen? A ka arritur/prekur ndërhyrja grupin e synuar?

Kriteri 2. Efikasiteti A ka të ngjarë që aktivitetet e parashikuara të çojnë në arritjen e objektivave? A ka ndonjë mënyrë për ta ofruar programin me kosto më efektive? A garantojnë rezultatet e arritura deri tani se objektivat do të arrihen? Cilët janë faktorët që ndikojnë në efektivitetin e pjesës x të ndërhyrjes? A janë zbatuar objektivat siç është planifikuar? Cilat ishin arsyet për suksesin e madh/mos-arritjen e objektivit x?

Kriteri 3. Eficienca A janë të justifikuara mirë mekanizmi i zbatimit - strukturat dhe proceset? Si mund të rritet efikasiteti i procesit? Çfarë procedurash institucionale duhet të thjeshtohen në mënyrë që zbatimi të bëhet më efikas? A është realizuar aktiviteti x duke përdorur qasjen me kosto më efikase? Sa e mirë ka qenë performanca e institucionit apo e procesit? Çfarë mësimesh mund të nxirren?

Kriteri 4. Ndikimi Cili është ndikimi i pritshëm i ndërhyrjes? Cilat janë grupet e synuara të ndikimit? A sjell ndërhyrja gjatë zbatimit disa efekte të padëshiruara? Cili është ndikimi i aktivitetit kundrejt pritshmërive? Pse është ndikimi më i ulët /më i lartë se sa pritej?



Kriteri 5. Qëndrueshmëria A ka të ngjarë që ndikimi të jetë afatgjatë? Cilat janë elementet që do ta garantojnë këtë? A ekzistojnë parakushtet për qëndrueshmërinë e objektivave? Çfarë mund të bëhet për të grasatuar që ato ekzistojnë? Cilët faktorë po ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e arritjeve? Cilat janë shanset që rezultatet do të zgjasin për një kohë të gjatë? Cilat janë kostot e ardhshme të parashikuara për programin? Cilat janë arsytet e qëndrueshmërisë së ulët të rezultateve?

Referenca dhe bibliografi

- MASR, "Ligj Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,"
- MASR, Ligj Nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (i azhurnuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, MASR, 2019.
- MASR, 31.10.2019. Ligji Nr. 15/2017 për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, 2017.
- Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010 për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, i ndryshuar Ligji Nr. 23/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 247, datë 4.3.2010, "për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve".
- European Union, "Council Recommendation of 22 May 2018 on key competences for lifelong learning (2018/C 189/01)," 2018
- European Commission, Albania 2020 Report - Communication on EU Enlargement Policy, 2020. MASR, Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, 2014.
- European Commission, "Albania 2019 Report - Communication on EU Enlargement Policy," 2019.
- Statuti i Universitetit të Tiranës
- Rregullore e Universitetit të Tiranës

DEKAN

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

